



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
**Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë**  
**Ministarstvo za Inovacije i Prudectništvo - Ministry of Innovation and Entrepreneurship**

---

Me qëllim të përkrahjes së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë në funksion të fuqizimit ekonomik dhe krijimit të vendeve të reja të punës, Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë (MIN) shpallë:

**Thirrje publike për financimin e Bizneseve Fillestare - “Start-Up”  
në fushën e  
Inovacionit dhe Ndërmarrësisë**

*Qëllimi*

Programi (fondi) për Inovacion dhe Ndërmarrësi për financimin e Bizneseve Fillestare – “Start-up”, është dizajnuar për të financuar bizneset e reja të regjistruara në ABRK si dhe iniciativat/idetë për krijimin e bizneseve të reja inovative, me qëllim të zhvillimit ekonomik dhe krijimit të vendeve të reja të punës. Financimi i start-upeve synon fuqizimin ekonomik të të rinjve, në jetësimin e ideve inovative dhe planeve të bizneseve.

Përfituesit e grantit të cilët janë në fillim të krijimit të idesë për themelimin e një biznesi duhet që brenda gjashtë muajve ta shndërrojnë idenë apo planin e biznesit në shoqëri tregtare të regjistruar ose planifikojnë ta bëjnë këtë sipas ligjeve të Kosovës.

*Mënyra dhe shuma e financimit për aplikuesit*

Përqindja e bashkëfinancimit nga aplikanti/ët (Start-Up) duhet të jetë 10% dhe nga Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë (Autoriteti Kontarktues) 90%.

Vlera maksimale e financimit për një aplikant është deri në 10,000.00 €.

Për të qenë i përshtatshëm për financim, përfituesit e grantit duhet të aplikojnë me një produkt apo shërbim potencialisht të tregtueshëm dhe një plan për të realizuar të ardhura dhe rentabilitet.

## *Përfituesit*

Individët, grupet dhe kompanitë të cilat kanë ide inovative biznesore, që kalojnë nga faza e para-inkubimit apo kanë kaluar fazën e inkubimit deri në aprovimin e idesë që konsiderohet se do të ketë efekte në ekonomi.

Përfituesit duhet të jenë partner produktivë dhe aktivë, të aftë për të dhënë rezultate të pritura, të angazhuara për zbatimin e planit të biznesit dhe të aftë për të përmbushur të gjitha kërkesat për raportim dhe monitorim.

## *Aktivitetet*

Idetë dhe planet e biznesit të propozuara për financim duhet të jenë në harmoni me objektivat dhe misionin e Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, si dhe me Udhëzimin Administrativ (MIN) 01/2018 për ndarjen e mjeteve financiare nga kategoria financiare e subvencioneve dhe transfereve.

Individët, grupet dhe kompanitë të cilët aplikojnë për mbështetje financiare për projektet dhe aktivitetet e tyre, duhet të kujdesen që projekt-propozimet të jenë në harmoni me objektivat e Politikës së Subvencionimit të Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë të cilat janë në funksion të Programit Qeveritar 2017-2021, politikave ekonomike dhe strategjike të Ministrisë, planit të punës së Ministrisë, si dhe objektivave kryesore të Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë:

1. Promovimi i inovacionit sipas sektorëve të ekonomisë në shërbim të rritjes ekonomike dhe zhvillimit;
2. Zhvillimi i ndërmarrësisë përmes programeve të trajnimit/ konsulencës;
3. Mbështetja e zhvillimit të Start-Up për ballafaqim me presion konkurrues në rajon, BE dhe tregjet e tjera.

Grantet do të përdoren për të mbështetur krijimin e ndërmarrjeve të reja inovative dhe promovimin e të rinjve dhe grave në biznes, të cilët dëshmojnë që mjetet e ndara do të ndikojnë në:

- Promovimin e inovacionit dhe ndërmarrësisë;
- Aktivitetet prodhuese dhe shërbyese;
- Rritjen e kapaciteteve eksportuese;
- Hapjen e vendeve të reja të punës;

- Investimin në hulumtim dhe zhvillim;
- Rritjen e investimeve;
- Rritjen e konkurrueshmërisë dhe kapaciteteve;
- Përmirësimin e proceseve dhe zhvillimin e produkteve të reja;
- Ngritjen e nivelit të pjesëmarrjes së të rinjve në të bërit biznes;
- Ngritjen e kapaciteteve njerëzore në shërbim të zhvillimit ekonomik;

*Llojet e Shpenzimeve të kualifikueshme (të lejuara) apo të pakualifikueshme (që nuk lejohen) sipas kësaj thirrje publik për financim (granti)*

**Sipas kësaj thirrje publik për financim (granti) do të përkrahen financiarisht aktivitetet e kualifikuara si më poshtë:**

- Paga bruto (vetëm për punonjësit e aplikantit)
- Shumat e pagave bruto për punonjësit e përfshirë në projekt duhet të jenë në përputhje me praktikën e përcaktuara të përfituesit para fillimit të projektit;
- Blerja ose qiraja e pajisjeve dhe furnizimeve që lidhen vetëm me proceset e hulumtimit dhe zhvillimit të projektit;
- Shërbimet për hulumtim dhe zhvillim si nënkontraktorë (p.sh. testim, shërbime laboratorike etj.)
- Angazhimi i ekspertëve / këshilltarëve për nevoja të tjera që lidhen drejtpërdrejt me rezultatet e pritura të projektit (ekspertiza lidhur me menaxhimin e inovacionit, menaxhimin financiar dhe kontabilitet, mobilizimin e fondeve dhe kapitalit, zhvillimin e biznesit, marketingun, çështjet ligjore, mbrojtjen e pronësisë intelektuale etj.);
- Mbështetja e zyrës apo biznesit (qeraja e objektit dhe shpenzimet për zyre);

Të pranueshme për financim janë vetëm shpenzimet për aktivitetet e kryera gjatë kohëzgjatjes së projektit dhe që janë në përputhje me buxhetin e projektit të aprovuar, rregullat dhe procedurat e thirrjes publike.

**Sipas kësaj thirrje publik për financim (granti) nuk do të përkrahen financiarisht apo janë të pakualifikuara këto aktivitetet:**

- Shpenzimet për pagesën e interesit ose të borxhit ndaj një pale tjetër;
- Shpenzimet dhe provizionet për humbjet dhe borxhet e së kaluarës dhe të mundshme në të ardhmen;
- Kostot për mbulimin e humbjeve të këmbimit valutor, tarifave dhe gjokat;
- Shpenzimet për argëtim dhe mikpritje;
- Shpenzimet e rekrutimit (kostot e publikimit të njoftimit, komisionet nga agjencitë e punësimit, shpenzimet lidhur me përzgjedhjen e kandidatëve, etj.) dhe kostot e zhvendosjes;
- Blerja e tokës apo ndërtesave, duke përfshirë çdo rinovim;
- Pagesat me mjete nga llogaria e projekti tjetër;

- Shpenzimet e transportit të produkteve;
- Tarifat vjetore për mirëmbajtjen e patentave;
- Shtesat për paga;
- Shpenzimet e shërbimeve të konsulencës të ofruara nga pronari apo përfituesit e projektit;
- Marrja me qira e hapësirës për zyre nga qiradhënësi që merr pjesë në aktivitetet e projektit ose është i lidhur me kapitalin e përfituesit/ve;
- Prokurimi i automjeteve komerciale dhe prokurimi i pajisjeve të dorës së dytë;
- Kostot për zbatimin e aktiviteteve të njëjta që janë financuar më parë nga buxheti i Qeverisë së Republikës së Kosovës apo organizatave të tjera qeveritare apo joqeveritare.

### *Kriteret e vlerësimit*

Vlerësimi i aplikacioneve do të bëhet në përputhje me objektivat e Programit (fondit) për Inovacion dhe Ndërmarrësi për financimin e Start-up. Mënyra e vlerësimit është përshkruar në tabelën e mëposhtme:

<b>Kriteret</b>	<b>Pikët totale</b>
Përputhja me objektivat e Programit (fondit) për Inovacion dhe Ndërmarrësi për financimin e Start-Up (niveli i inovacionit për aktivitetin e propozuar)	1-30 Pikë
Mundësia e realizimit të suksesit në arritjen e rezultateve të synuara.	1-40 Pikë
Krijimi i vendeve të reja të punës (me përparësi gratë dhe të rinjtë)	1-20 Pikë
Numri i përfitueseve nga granti, sa krijon vlerë të shtuar?	1-10 Pikë
<b>Pikët totale të mundshme</b>	<b>100 pikë</b>

## FORMULARI I APLIKIMIT

Numri i referencës: \_\_\_\_\_

Data: \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_\_\_

(Të plotësohet nga aplikuesi)

I. INFORMATAT E PËRGJITHSHMË TË APLIKUESIT	
1. Emri dhe Mbiemri	
2. Numri personal	
3. Data e lindjes	
4. Vendbanimi (Komuna)	
5. Nacionaliteti	
6. Gjinia	
7. Profesioni	
8. Nr. i telefonit	
9. E-mail adresa	
10. A keni biznes të regjistruar?	<input type="checkbox"/> PO <input type="checkbox"/> JO
i. Nëse jo, ju lutemi jepni informacione nëse planifikoni dhe kur planifikoni ta regjistroni?	
ii. Nëse po, listoni:	
iii. Emri i biznesit	
iv. Numri i biznesit	
v. Data e regjistrimit	
vi. Lloji i biznesit (Përgjegjësi e kufizuar, Biznes individual, Ortakëri, Korporatë, etj.)	
vii. Emri (at) i pronarit (ët) të biznesit	
viii. Adresa e plotë e biznesit	
ix. Banka dhe numri i llogarisë së biznesit	
x. Emri (t) e përfaqësuesve të autorizuar të biznesit	
xi. Informata se në çfarë sektori vepron biznesi juaj (p.sh. prodhim, industri e shërbimit etj.)	

11. Përshkruani idenë tuaj për biznes:

12. Përshkruani produktet që do të prodhoni apo shërbimet që do të ofroni:

13. Cilët janë klientët tuaj të synuar?

14. Cilët janë konkurrentët tuaj dhe si do t'i qaseni atyre?



15. Përshkruani se si do të reklamoni dhe promovoni shitjet:

16. Përshkruani strukturën organizative ekzistuese ose të propozuar të biznesit:

17. Qëllimi dhe objektivat e aplikimit për grant:

18. Nëse do të jeni përfitues të grantit, si do t'ju ndihmojnë mjetet që t'i arrini qëllimet tuaja të biznesit? Listoni rezultatet specifike të parashikuara:

19. Nëse do të jeni përfitues të grantit, si do t'i përdorni mjetet?  
Përshkruani detajet më poshtë:

## AFATET KOHORE / PLANI I PUNËS

Plani i punës për periudhën nga ___/___/____ deri ___/___/____ (periudha maksimale deri në 6 muaj). Ju lutemi listoni aktivitetet e planifikuara sipas muajit në tabelën më poshtë.						
	Muaji 1	Muaji 2	Muaji 3	Muaji 4	Muaji 5	Muaji 6
<b>Aktivitetet</b>						

*Vini re: Grantet e Programit (fondit) për Inovacion dhe Ndërmarrësi për financimin e Start-up janë deri në vlerën prej 10,000.00 € si dhe duhet të realizohen për një periudhë deri në gjashtë muaj.*

## BUXHETI

Formulari i Buxhetit		
<p>Ju lutemi tregoni kostot financiare të nevojshme për të përfunduar aktivitetet e planifikuara.</p> <p>Ju mund të shtoni më shumë linja Aktivitete nëse është e nevojshme.</p>		
Linja buxhetore	Përshkrim i detajuar	Shuma
Aktiviteti Nr.1		€
		€
		€
		€
Total Aktiviteti Nr.1		€
Aktiviteti Nr.2		€
		€
		€
		€
Total Aktiviteti Nr.2		€
Aktiviteti Nr.3		€
		€
		€
		€
Total Aktiviteti Nr.3		€
Aktiviteti Nr.4		€
		€
		€
		€
Total Aktiviteti Nr.4		€
<b>TOTAL</b>		<b>€</b>

Të tjera	
<i>Informata dhe komete shitesë (nëse keni):</i>	
<p>Aplikuesi deklaron që të gjitha informatat në këtë aplikacion janë të vërteta dhe të plota, përfshirë çdo dokument të bashkangjitur, si dhe pranon detyrimin për të përmbushur kushtet e Thirrjes publike për financimin e Bizneseve Fillestare – “Start-Up” në fushën e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë.</p>	
<p><b>Emri dhe mbiemri:</b> _____</p>	
<b>Nënshkrimi:</b>	<b>Data:</b>

- Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 30 ditë pas hapjes së Thirrjes publike për financimin e Bizneseve Fillestare - “Start-Up” në fushën e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë dhe përfundon me datën 15/08/2018;
- Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë;
- Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën e Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë në kopje fizike dhe CD;
- Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike;
- Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: [info.min@rks-gov.net](mailto:info.min@rks-gov.net);
- Bashkangjitur letërnjoftimi i Republikës së Kosovës i lëshuar nga organet kompetente të Republikës së Kosovës për persona fizik;
- Certifikata e regjistrimit të biznesit me të gjitha informatat përcjellëse (nëse është i regjistruar);
- Dëshminë e xhirollogarisë aktive të aplikuesit në njërin nga Bankat e licencuara nga BQK;
- Gjendja e xhirollogarisë bankare të aplikuesit për vitin e fundit. Për aplikuesit e sapo themeluar kjo nuk është e aplikueshme;
- Aplikuesi duhet të ketë kryera të gjitha detyrimet tatimore ndaj ATK-së - duhet të dorëzohet vërtetimi tatimor;
- Të kenë të kryer të gjitha detyrimet nga mbështetja financiare paraprake, nëse kanë përfituar nga burimet publike të financimit nga Buxheti i Republikës së Kosovës;
- Aplikuesi nuk duhet të ketë pranuar mjete financiare nga Buxheti i Republikës së Kosovës për realizimin e të njëjtave aktivitete në vitin përkatës fiskal;